



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.193/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Fejzullah Rexhepi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fatjona Bekteshi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterit të kandidatit të tyre në afërsi të objekteve publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06 tetor 2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 05.10.2019, mori këtë:

VE N D I M

Pranohet e bazuar ankesa A.nr. 193/2019 e datës 02.10.2019, e paraqitur nga Organizatës Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike - vendosja e posterit brenda rrethojës së objektit të Agjencisë së Punësimit, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, për fushatën zgjedhore, i shqiptohet gjobë në lartësi prej 5,200.00 (pesë mijë e dyqind) euro, të cilën gjobë detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë të këtij vendimi, nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Me datën 02.10.2019, Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova ka paraqitur ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se me datë 01.10.2019 rreth orës 14:00, në Komunën e Prizrenit, në oborrin e institucionit Agjencia e Punësimit, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, është i vendosur bilbordi i kandidatit për deputet Kujtim Gashi nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK). Me tutje parashtruesi i ankesës thekson se edhe nëse Komuna i ka paraparë si vende në të cilën mund të vendosen materialet promovuese, ky bilbord është i vendosur brenda hapësirave të institucionit dhe si e tillë është në kundërshtim me Rregullën Zgjedhore nr.13/2013, “Fushata e Zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet politike”, përkatësisht nenit 3 pika 3.4. Parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tyre si provë ka bashkangjitur disa fotografi.

Në përgjigjen në ankesë të datës 03.10.2019, subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), thekson se për vendosjen e këtij bilbordi, kandidati për deputet nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kujtim Gashi ka marrë pëlqim nga SHPK “Sfinga”, si pronare e asaj hapësire, kjo dëshmohet nga deklarata e lëshuar nga e njëjta, kopjen e së cilës e kemi bashkangjitur në përgjigje. Më tutje në përgjigje subjekti politik PDK thekson se e kemi evituar shkeljen, por për këtë pretendim nuk kanë bashkangjitur asnjë provë.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën dhe shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LPZ-së, gjeti se: **Ankesa është e bazuar**

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se bilbordi i kandidatit për deputet Kujtim Gashi, nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës

(PDK), është vendosur brenda rrethojës së Agjencisë së Punësimit, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, dhe provat tjera siç janë deklarata mbi dhënien e pëlqimit të Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe deklarata e noterizuar e lidhur ne mes te subjektit politik PDK dhe e nënshkruar në emër të të njëjtit subjekt politik Kujtim Gashi i cili nuk ka deponuar dëshmi se e njëjta pronë është pronësi private, dhe konsiderojmë se kemi te bëjmë me shfrytëzimin e pronës publike te Agjencisë së Punësimit - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së, e cila përcakton: *“Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe postereve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugë publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve”*.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik PDK, është shkelur neni 33 pika (b) të LZP-së, pasi që billboardi i kandidatit për deputet nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), është i vendosur në vendin i cili nuk është i dedikuar për vendosjen e billboardëve përkatësisht brenda oborrit të institucionit publik.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret, se subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se është njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe për kundër këtij fakti billboardi i kandidatit të këtij subjekti politik është vendosur brenda ndërtesës publike. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që subjektit politik në fjalë, iu dha mundësia për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se nuk e kanë pranuar shkeljen dhe nuk kanë marrë masa përmirësuese, veprim ky i cili ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.193/2019 më datën 05.10.2019

Kryesues i Panelit
Zyhdi Haziri

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.